



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	23.05.2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZATO:	z. Blerim Dina Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
CC:	z. Nenad Stojcetovic Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për ritender "Furnizimi me automjete"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me ritenderimin "Furnizimi me automjete" me numër të prokurimit: **13023111**, ofron këtë:

OPINION

Kërkohe nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin Publik "Furnizimi me automjete", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim, në rolin e Autoritetit Kontraktues, ka përgatitur njoftimin për kontratë "Furnizim" duke e publikuar atë në web faqen e KRPP-ës. Dhe për herën e parë më 23.04.2013 e më pas më datën 08.05.2013 e njëjta kërkon anulimin e saj duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit të Prokurimit. Mu për këtë, me datën 10.05.2013 në web të KRPP-ës shpallet **Ritenderi** me titull: "Furnizimi me automjete" me numër të prokurimit: **13023111**, në procedurë të hapur. Çuditërishtë dosja është përgatitur me të njëjta specifikacione për vetura, edhe pse ka pasur kërkesa nga disa operator që të ndryshohen.

1. Procedura në fjalë është inicuar me kërkesën e njësisë kërkuese konkretishtë "Inicimi i procedurave të prokurimit për blerjen e veturave". Fillimishtë në tekst vihet re në një gabim teknik ku kërkohen të blihen **12 (11+1)** vetura dhe pastaj korrigjohet dhe numri i përgjithshëm i veturave zbret në **10 (1+4+5)**.

2. Në bashkëlidhje me kërkesën janë përpiluar edhe **Specifikacionet teknike** të cilat duhet t'i përmbajnë veturat (3 lloje të ndryshme të specifikacioneve). Specifikacionet të cilat na bëjnë të dyshojmë për favorizimin e një operatori ekonomik dhe menjanimin e operatorëve tjetër nga gara. Andaj, vini re **listën e specifikacioneve**:

sasia është 1 veturë janë të limituara disa nga vecoritë, e ato janë: **Vëllimi i motorit (3.8–5.0 ccm)**, **Ndërruesi i shpejtësive (8 shpejtësi)**; element i cili lidhet vetëm me karakteristikat e veturës së tipit Hyndai (i cili është OE-tenderues).

Poashtu, në dy listat (listën për 4 vetura dhe listën për 5 vetura) në specifikacione të veturave janë të limituara këto veçori: **Gjatësia min. Lartësia min.**

3. Kërshëria tjetër në fazën e hetimeve e drejton Agjencisë kundër Korrupsionit tek procedura e dorëzimit të dosjeve. Aplikon edhe një operator ekonomik i cili nuk posedon shumicën e dokumentacioneve, madje edhe dosja e tij na paraqitet e pa plotësuar, ashtu që ky veprim krijon kushte për të dyshuar se operatori në fjalë ka aplikuar për: 1. ta përmbushur numrin; dhe 2. për të krijuar situatë të favorshme për operatorin ekonomik tjetër. Dosjet (faktet) e të cilave i posedon edhe autoriteti kontraktues. Bazuar në objektin e kontratës Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit nuk ka paraqitur **specifikimet teknike** të cilat lejojnë pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë. Mos specifikim i saktë i karakteristikave të disa artikujve në Dosjen e Tenderit ndikon që operatorët tjerë të tërhekin dosjet e tyre. Agjencisë kundër Korrupsionit gjatë realizimit të kontakteve me disa nga operatorët ekonomik për çështjen e tërheqjes së dosjës u është bërë e ditur se Autoriteti Kontraktues, konkretishtë njësisë kërkuese ka përgatitur specifikimet të cilat nuk lejojnë qasje të barabartë për të gjithë tenderuesit duke krijuar pengesa për ofertim dhe eliminuar konkurrencën në treg.

Me veprimet e tilla, Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar këto dispozitat:

Dispoziata e nenit 7, 27, dhe nenit 28 të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Me respekt!